



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-104

Prishtinë, më 15 prill 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 PRILL 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Liburn Aliu, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 prill 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 prill 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 prill 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vazhdimin e mbledhjes plenare, të filluar më 11 prill 2013, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të enjten, më 18 prill 2013 në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990 deri në vitin 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe rekomandimeve të komisioneve parlamentare

Ndërsa për mbledhjen plenare të radhës, Kryesia vendosi që ajo të mbahet të enjten, më 18 prill 2013 në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organet qeveritare për Shoqërinë e informacionit,
5. Debat parlamentar lidhur me ndërmarrjen "Trepça", sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,
6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Pikat shitesë:

1. Shqyrtimi i propozim-Kornizës afatmesme të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitet 2014-2016

Sekretari e informoi Kryesinë për përmbajtjen e Kornizës afatmesme të shpenzimeve për Kuvendin e Kosovës për vitet 2014-2016, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Lidhur për këtë çështje diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi Kornizën afatmesme të shpenzimeve për Kuvendin e Kosovës për vitet 2014-2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Korniza afatmesme e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitet 2014-2016,

2. I rekomandohet Ministrisë së Financave që e njëjta të përfshihet në Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitet 2014-2016.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me projektin kapital të Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi, gjithashtu e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Administrata e Kuvendit që ta përgatisë një informatë për gjendjen e Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi, si dhe parallogaritë e kostos financiare për përfundimin e saj dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë për mbledhjen e radhës.

2. Propozim për ftesë të ekspertëve nga Sllovenia për ekspertizë teknike lidhur me modernizimin dhe implementimin e disa funksionaliteteve specifike në sistemin konferencial në sallën plenare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të akomodimit për dy ekspertë të Parlamentit të Sllovenisë që do të qëndrojnë në Kuvendin e Kosovës për tri (3) ditë, në vlerë të përafërt prej 1 600,00 euro.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale